

V E N D I M
Nr.348, datë 13.5.1996

**PËR ZBATIMIN E MASAVE VETERINARE EMERGJENTE PËR IZOLIMIN DHE
ÇRRËNJOSJEN E INFEKSIONIT VIRUSAL NË GJEDH**

Në zbatim të ligjit nr.7674, datë 23.2.1993 “Për Shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar” e të Kodit Ndërkombëtar të Shëndetit të Kafshëve, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të shpallet karantina shtetërore në vatrat me infeksion viral të gjedhëve në rrethet e prekura të Korçës e të Pogradecit, si dhe në rrethet ku eventualisht do të identifikohet sëmundja.
 2. Të thehen dhe të digjen të gjitha krerët e vatrave të prekura.
 3. Të dërgohen në qendrat ndërkombëtare të referencës materiale patologjike edhe specialistët përkatës për të realizuar identifikimin dhe tipizimin e shkaktarit të infeksionit.
 4. Në zbatimin e masave karantinore, krahas strukturave shtetërore veterinarë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, të marrin pjesë edhe organet e rendit, të kufirit e të pushtetit lokal.
 5. Për mbulimin e shpenzimeve në zbatim të këtij vendimi caktohen 20 milionë lekë nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, titulli 11, kapitulli 1 “Mbrotjtja e mjedisit nga pesticidet”, do t’i kalohen titullit 1, kapitulli 1 “Shpenzime për diagnostikimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive në veterinarë”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi